



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PUSTEC**

Nr. \_\_\_\_ .prot

Pustec me; \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“Blerje varke”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Kodi (CPV): 34520000-8**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

Fond limit : **6 600 000 (gjashte million e gjashteqind mije) leke pa tvsh.**

Në mbështetje të Ligjit Nr.162,datë 23.12.2020, dhe Ligjit Nr.16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 55 “Procedure e hapur e Thjeshtuar”, Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik”, Kreu IX “Rolet dhe Përgjegjësia ne Autoritetin/EntinKontraktor”, Neni 73, “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”dhe Urdhërit të Prokurimit **Nr.8 datë 28.05.2026** të Kryetarit të Bashkisë Pustec, Njesia e Prokurimit morri në shqyrtim dokumentet e tenderit me objekt: **“Blerje varke”**

A - Për këtë në bazë të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, u hap faqja e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik nga ku u morrën dokumentat standarte të tenderit. Këto dokumenta u përzgjedhen për procedurën e përcaktuar në Urdherin e Prokurimit **Nr.8 datë 28.05.2026** dhe u procedua si me poshtë:

1. U plotësuan dokumentat e tenderit të mësipërm sipas Dokumentave Standarte të tenderit dhe u përgatiten për hedhjen në sistem.

2. Kërkesat e Përgjithshme për kualifikim të mbeten ato që përcaktohen në Dokumentat Standarte.
3. Kërkesat e veçanta për kualifikim të vendosen si më poshtë:
4. Për përllogaritjen e fondit limit, AK i është referuar ofertave të OE-ve pas studimit të tregut

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Pustec** ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

### 2. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Jane ato të paraqitura në DST dhe nuk ndryshojnë nga njesia e prokurimit.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

#### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të vërtetuar të bilancit të vitit 2023,2024,2025, të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “*Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar*”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin

financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

**Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve dhe xhiros mesatare është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet*

*kombëtare të kontabilitetit, kur, nëmbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tretreguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, nëmbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionëlekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".***

**2.2.2** Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2023, 2024,

2025) nga data e publikimit të tenderit lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se 15% të vlerës së fondit limit qëprokurohet, perkatesisht 990 000 (nenteqind e nentedhjetë mijë) leke pa tvsh.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, për vitin 2025 , pranë njësisë të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar dhe për vitin 2026 sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimevetë nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.**

\* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

**Argumentimi:** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

\* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera (realizuara) gjatë tri viteve të fundit nga data e

zhvillimit te tenderit, me një vlerë jo më të vogël 15% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, perkatesisht 990 000 (nenteqind e nentedhete mije) leke pa tvsh.

Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur :

- Kontratën e nënshkruar me institucionin,
- Vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate.
- Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur:
  - Faturën përkatëse tatimore ku të jetë shënuar data, shuma, sasia e mallrave të furnizuara, të nënshkruar nga të dyja palët.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.4** Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin një deklaratë me shkrim me anë të së cilës marrin përsipër të kryejnë shërbimin e transportit të mallit objekt prokurimi brenda afatit dhe sipas specifikimeve teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në formularin e njoftimit të kontratës.

**Argumentimi:** Ky kriter plotësohet me Vetdeklarim

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Dhënia e informacionit të rremë, përbën shkak për skualifikim, si dhe do të vepohet conform parashikimeve të LPP.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

*Per kriteret e percaktuara ne Kapacitetin teknik, Njesia e prokurimit ka zbatuar VKM Nr162, datë 23.12.2020, "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik" Sesioni III, "Kerkesa te vecanta sipas tipeve te kontratave" neni 40" Kerkesa te vecanta per kontratat e mallrave".*

## 2.4 Specifikimet teknike

- 1- Kategoria: - Varke
- 2- Fuqia e motorit : - 200-210 hp.
- 3- Gjatesia e varkes - 8 - 9 m
- 4- Gjeresia e varkes - 2.6 – 2.8 m
- 5- Thellesia e formuar - 1.2 – 1.3 m
- 6- Shpejtesia e varkes - 40 – 70 km/ore
- 7- Lenda djegese e motorit benzine
- 8- Pesha e varkes - 1900 – 2000 kg
- 9- Depozita e karburantit - 280 – 300 litra
- 10- Numuri i uleseve - 18 – 20 ulese
- 11- Varka te jete e re e pa perdorur
- 12- Pajisjet e perfshira
  - a) Panel instrumentesh 1 set
  - b) Parmak (Handrail) 1 set
  - c) Drite navigimi 1 set
  - d) Panel komandimi (switch board) 1 set
  - e) Drita navigimi 1 çift
  - f) Pompa e bilges e perfshire
  - g) Panel komandimi i perfshire
  - h) Bateria dhe kutia e baterise te perfshira
  - i) VHF radio e perfshire
  - j) Busull e perfshire
  - k) Sistem audio bluetooth me altoparlante i perfshire
  - l) Detektor tymi i perfshire
- 13- Ne momentin e dorezimit varka duhet te disponoje dokumentacionin e meposhtem te vlefshem :
  - Leje qarkullimi.
  - Çertifikate pronesia
  - Çertifikate e kontrollit teknik te mjetit
  - Police sigurimi

24-Para marjes ne dorezim te varkes ,per dy dite te demostrohesh funksionimi i pajisjeve dhe venia ne pune e tyre.

### Argumentimi i specifikimeve teknike

**Argumentimi:** Bashkia Pustec, duke qenë një nga destinacionet më të veçanta natyrore dhe turistike në Shqipëri, me pozicion strategjik në brigjet e Liqenit të Prespës, ka nevojë për zgjerimin e ofertës turistike në funksion të rritjes së numrit të vizitorëve, promovimit të trashëgimisë natyrore dhe zhvillimit të ekonomisë lokale.

Në këtë kuadër, blerja e një varke turistike me kapacitet 18–20 ulëse dhe motor 200–210 HP përbën një investim të nevojshëm dhe funksional për Bashkinë Pustec, duke krijuar mundësi për organizimin e tureve turistike dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore për vizitorët.

Kapaciteti i propozuar garanton funksionim praktik dhe eficiencë në transportin e grupeve turistike, ndërsa motori me fuqi 200–210 HP siguron lëvizje të sigurt dhe të qëndrueshme në

ujërat e Liqenit të Prespës, performancë optimale në kushte të ndryshme atmosferike dhe transport të sigurt të pasagjerëve.

Gjithashtu, pajisjet e përfshira, si sistemi i navigimit, VHF radio, pompa e bilges, dritat e navigimit, parmakët mbrojtës, sistemi audio dhe detektori i tymit, janë elementë të domosdoshëm për garantimin e sigurisë, standardeve të lundrimit dhe cilësisë së shërbimit turistik.

Në përfundim, blerja e varkës turistike me specifikimet teknike të propozuara përbën një investim të domosdoshëm për Bashkinë Pustec, në funksion të zhvillimit të turizmit liqenor, përmirësimit të shërbimeve ndaj vizitorëve dhe promovimit të zonës së Prespës si destinacion turistik me potencial të lartë zhvillimi.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Në hartimin e specifikimeve teknike njësia e prokurimit i ka qëndruar me rigorozitet kuadrit ligjor në fuqi dhe Rekomandimit të APP, duke caktuar një minimum të mundshëm për specifikimet konkrete të mjetit, si fuqia e motorit, pesha e tij, ngritja e krahut, gjatësia e kovës me skrapat etj.

Plotësimi i specifikimeve teknike si më sipër cituar mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatet dhe ofertuesit, dhe nuk shërbejnë si pengesë për konkurimin e hapur për prokurimin publik.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se hartimi i specifikimeve teknike është kryer në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, dhe i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Hartimi i specifikimeve teknike përmbushen nga një shumëllojshmëri markash dhe modelesh fadromash në treg, duke rritur njëkohësisht konkurrencën midis operatorëve ekonomik të interesuar.

**Mosplotësimi i specifikimeve teknike si më sipër cituar nga ana e operatorëve ekonomik ofertues, do të çoj në skualifikimin e operatorit ekonomik.**

**Mjeti do të merret në dorëzim nga një komision i posaçëm, vetëm në rastet kur plotësohen specifikimet teknike të hartuar nga autoriteti kontraktor.**

KOMISIONI